



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:026604

Datë: 25.10.2018

Numri i dokumentit: 00154456

PKR.nr.85/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për krime të rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajsër Skenderi, me procesmbajtësen Sheqere Braha, në çështjen penale të akuzuarit E. M., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.2.lidhur me par.1. të KP dhe veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.5.lidhur me par.2. të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë themelore në Prizren – Departamenti për krime të rënda PP/I.nr.65/18 të datës 16.10.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencën e Prokurorit të shtetit Metush Biraj, të akuzuarit dhe mbrojtësve të tij av.A. R. dhe B. Gj., me datën 22.10.2018 muarr dhe publikisht e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E. M., nga i ati B. dhe e ëma K. e lindur T., i lindur më *data e lindjes* në Prizren, ku edhe tani banon në rrugën ..., ndërtesa banesore ..., banesa nr..., e ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në ndërmaren “S. A. P.”, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës në paraburgim gjindet prej datës 11.06.2018.

ËSHTË FAJTOR

1.Ka mbajtur në pronësi, armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla në atë mënyrë që më datën 11.06.2018 rrethë orës 19:50 minuta, në rrugën .. afër E. për punësim në Prizren, duke drrejtuar automjetin e tipit “Shkoda” me taga *numri i targës*, në fiokë ka mbajtur të fshehur pistoletën e tipit “Glock”, me nr.serik 00266 me katër fishek të kalibrit të panjohur, kurse në banesën e tij nr..., në ndërtesën banesore ..., në rrugën ... në Prizren, ka

mbajtur 64 fishek të kalibrit të panjohur dhe 87 fishek me gaz, një shufër metalike me futrollë, një sprej, një elektrohok, një granat dore, një karikator dhe një palë preanga me futrollë.

Këso dore ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.2.lidhur me par.1. të KP.

2.Në vend dhe kohë të njejtë të përshkruar më afërsisht sikurse në pikën (1) të dispozitivit të aktakuzës njëherit ka poseduar para të falsifikuara me qëllim që ti vë në qarkullim si të vërteta, sasia e të cilave ka tejkaluar 100.000 Euro, në dhomën e banesës së tij ka pasur 321 x 500 kartëmonedha Euro të falsifikuara me numra serik X006505294331, 170 x 200 kartëmonedha Euro të falsifikuara, me nr. serik XL05820188449, 233 x 50 kartëmonedha Euro të falsifikuara, 299 x 100 Euro me nr.serik 284014809555 dhe një kartëmonedhë prej 5 Euro me nr.serik YA0890633825 të falsifikuara.

Këso dore ka kryer veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.5 e lidhur me par.2. të KP.

Andaj, gjykata konformë dispozitave të nenit 7, 17, 41, 43, 45, 62 par.2, pika 2.6, 73, 75, 76, 80, 83, në lidhje me nenin 374 par.2.në lidhje me par.1. dhe nenin 302 par.5.në lidhje me par.2. të KP, e

G J Y K O N

Për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.2. të KP, me dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 1 /një/ viti**.

Për veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.5.lidhur me par.2. të KP, me dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 2 /dy/ vite e 6 muajëve**.

Andaj, gjykata konformë dispozitave të nenit 80 par.2.pika 2.2. të KP, ia shqipton **dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 /tri/ viteve**, në të cilin dënim me burgim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 11.06.2018 gjerë më 22.10.2018.

Nga i akuzuari E. M. konfiskohet pistoleta e tipit “Glock” me nr.serik 00266 me katër fishekë të kalibrit të panjohur, 64 fishekë të kalibrit të panjohur dhe 87 fishekë me gaz, një shufër metalike me futrollë, një sprej, një elektrohok, një granatë dore, një karikator dhe një palë pranga me futrollë, 321 x 500 kartëmonedha Euro të falsifikuara me nr.serik X006505294331, 170 x 200 kartëmonedha Euro të falsifikuara me nr.serik X L05820188449, 233 x 50 kartëmonedha Euro të falsifikuara, 299 x 100 kartëmonedha Euro të falsifikuara me nr.serik PO 471198281, një kartëmonedhë prej 10 Euro me nr.serik 284014809555 dhe një kartëmonedhë prej 5 Euro me nr.serik YA0890633825, si mjete të kryerjes së veprave penale.

Oblirohet i akuzuari që konformë Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej 50 Euro për programin e kompenzimit të viktimave të krimit.

Obligohet i akuzuari që në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të paguajë paushalin gjyqësor në shumën prej 100 Euro.

Ar sy e t i m

Prokuroria e Shtetit në Prizren – Departamenti për krime të rënda kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr.65/18 të datës 16.10.2018 kundër të akuzuarit E. M., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.2.lidhur me par.1. të KP dhe veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.5.lidhur me par.2. të KP.

I akuzuari E. M. gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajsinë për veprat penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.2.lidhur me par.1. të KP dhe veprën penale falsifikimi I parasë nga nei 302 par.5.lidhur me par.2. të KP.

Prokurori I shtetit pas pranimit të fajsisë të bërë nga ana e të akuzuarit i ka propozuar gjykatës ti merrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit dhe të ia shqiptoi dënimin e paraparë me ligj.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokat A. R. ka kërkuar nga gjykata që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese, si pranimin e fajsisë, pendimin dhe se konformë nenit 76 par.1.3. të KPP ti zbaton kufijtë e zbutjes së dënimit, pasiqë edhe me dënimin e paraparë sipas këtij neni do të arrihet qëllimi i dënimit.

Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe i akuzuari E. M. duke I propozuar gjykatës që të ia shqipton një dënim sa më të butë pasiqë është penduar për veprat e kryera, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të bie në konflikt me ligjin dhe as që do të kryej vepra të këtilla apo të ngjajshme.

Në shqyrtimin fillestar pasiqë i akuzuari e ka pranuar fajsinë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KP dhe veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.5.lidhur me par.2. të KP, andaj, edhe gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësise, i cili pranim është bërë konformë nenit 248 të KPP, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, pranimi i fajsisë është bërë vullnetarisht pas konsulltimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tij, pranimi i fajsisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezentuara nga Prokurori i shtetit dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KP pasiqë i akuzuari E. M., ka mbajtur në pronësi, armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armëet e tilla në atë mënyrë që më datën 11.06.2018 rrethë orës 19:50 minuta, në rrugën ... afër Entit për punësim në Prizren, duke drrejtuar automjetin e tipit “Shkoda” me taga *numri i targës...*, në fiokë ka mbajtur të fshehur pistoletën e tipit “Glock”, me nr.serik 00266 me katër fishek të kalibrit të panjohur, kurse në banesën e tij nr..., në ndërtesën banesore..., në rrugën ...në Prizren, ka mbajtur 64 fishek të kalibrit të panjohur dhe 87 fishek me gaz, një shufër metalike me futrollë, një sprej, një elektroshok, një granat dore, një karikator dhe një palë preanga me futrollë.

Poashtu në bazë të pranimit të fajsisë gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen edhe elementet qenësore të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.5.lidhur me par.2. të KP, pasiqë në vend dhe kohë të njejtë të përshkruar më afërsisht sikurse në pikën (1) të dispozitivit të aktakuzës njëherit ka poseduar para të falsifikuara me

qëllim që ti vë në qarkullim si të vërteta, sasia e të cilave ka tejkaluar 100.000 Euro, në dhomën e banesës së tij ka pasur 321 x 500 kartëmonedha Euro të falsifikuara me numra serik X006505294331, 170 x 200 kartëmonedha Euro të falsifikuara, me nr. serik XL05820188449, 233 x 50 kartëmonedha Euro të falsifikuara, 299 x 100 Euro me nr.serik 284014809555 dhe një kartëmonedhë prej 5 Euro me nr.serik YA0890633825 të falsifikuara.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konformë nenit 41 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë, motivet nga të cilat është kryer vepra penale, prej rrethanave lehtësuese morri parasysh faktin se i akuzuari e ka pranuar fajsinë ,nuk ka qenë përpara i dënuar për ndonjë vepër penale, se është hera e parë që bien në kundërshtim me ligjin, mbajtjen korrekte të tij në gjykim.Pasiqë rrethana rënduese nuk gjeti, andaj është mendimi i gjykatës që dënimi i shqiptuar do ta arrij qëllimin e vet konformë nenit 41 të KP, se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe se do të mundësoj një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarve ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit. Gjukata është e mendimit se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaqërisht të asaj të posaçme, se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit në të gjitha segmentet e saj.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi kërkesën pasuroro-juridike është marrë konformë nenit 463 par.2. të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 450 par.2 pika 2. 6 në lidhje me nenin 453 par.l. të KPP.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për krime të rënda
Më dt.22.10.2018,PKR.nr.85/18

G j y q t a r i

Ajser Skenderi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.